



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI BASHKIAK
TEPELENE

V E N D I M

Nr. 44 Datë. 24.12 2017

PER

MIRATIMIN E KALENDARIT TE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM
DHE I BUXHETIT VJETOR

Keshilli i Bashkise Tepelene ne mbledhjen e dates 24.12 2017 pasi mori ne shqyrtim materialin e paraqitur nga Kryetari i Bashkise « kalendarine e programit buxhetor afatmesem dhe buxhetit vjetor « mbeshtetur ne :

- Ligjin 139/2015 –date 17.12.2015, “Per vetqeverisjen vendore ”,
- Ligjin 9936, datë 26.06.2008 “ “ Per menaxhimin e sistemit e buxhetor ne Republiken e Shqiperise”; i ndryshuar
- Ligji nr 68/2017 « Per financat e vetqeverisjes vendore «
- Udhezimit nr 23 date 22.11.2016 “Per procedurat standarte te pergatitjes se Programit Buxhetor Afatmesem ”
- Udhezimit plotesues nr 10/2 date 13.07.2017 “Per pregatitjen e buxhetit vendor “

V E N D O S I:

Te miratoje kalendarine e programit buxhetor afatmesem dhe buxhetit vjetor si me poshte ;

1. Kryetari Bashkise paraqet për shqyrtim e miratim në këshill raportin për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për:

- a) dy vitet para vitit buxhetor;
- b) vitin buxhetor;
- c) tre vitet e ardhshme buxhetore

Jo më vonë se data 31 janar

2. Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore miraton raportin e vlerësimeve dhe të parashikimeve afatmesme të të ardhurave **jo më vonë se data 1 mars**

3. Bazuar në vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave të miratuara dhe në vlerësimet afatmesme të transfertave të përcaktuara në udhëzimin e përgatitjes së buxhetit vendor të Ministrisë së Financave, Kryetari i Bashkise përgatit dhe paraqet për miratim në Keshillin Bashkiak tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm në nivel programi.

Keshilli Bashkiak miraton tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm **jo më vonë se data 15 mars**.

4. *Jo më vonë se 5 ditë nga data e miratimit të tavanëve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm*, Kryetari i Bashkise miraton udhëzimin e përgatitjes së buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe e shpërndan tek të gjitha njësitë shpenzuese.

5. Brenda datës 1 qershor, Kryetari i Bashkise i dërgon Ministrisë së Financave projektdokumentin e programit buxhetor afatmesëm.

6. Projekti paraqitet në keshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore nga Kryetari i Bashkise dhe shoqërohet me mendimin zyrtar të Ministrisë së Financave.

Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore shqyrton dhe miraton projektin e parë të programit buxhetor afatmesëm, duke shprehur edhe opinionin e tij për rekomandimet e Ministrisë së Financave. **Brenda datës 30 qershor**

7. Kryetari i Bashkise merr masat e nevojshme për publikimin e dokumentit të parë të programit buxhetor afatmesëm të miratuar, **brenda datës 5 korrik**.

8. Bazuar në vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të përditësuara të të ardhurave dhe transfertave nga Buxheti i Shtetit, të përcaktuara në udhëzimin plotësues të përgatitjes së buxhetit vendor të Ministrisë së Financave, kryetari i Bashkise përgatit dhe paraqet për miratim në Keshillin Bashkiak tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm në nivel programi. Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore miraton tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm **brenda datës 20 korrik**.

9. *Jo më vonë se 5 ditë pas miratimit të tavanëve të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm*, kryetari i bashkise nxjerr udhëzimin plotësues për përgatitjen e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe e shpërndan tek të gjitha njësitë shpenzuese.

10. **Brenda datës 15 shtator**, Bashkia dërgon në Ministrinë e Financave dokumentin e programit buxhetor afatmesëm të rishikuar, të miratuar nga Keshilli

Bashkiak , së bashku me një informacion mbi rekomandimet e dhëna nga Ministria e Financave gjatë fazës së parë.

11. Pas marrjes së mendimeve përfundimtare nga Ministria e Financave dhe bashkërendimit me projektbuxhetin vjetor, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit projektin e programit buxhetor afatmesëm përfundimtar dhe e paraqet për shqyrtim e miratim në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, së bashku me projektbuxhetin vjetor, **jo më vonë se data 30 nëntor e vitit buxhetor.**

Kryetari i Bashkise , në një aneks të veçantë të projektit të programit buxhetor afatmesëm përfundimtar, paraqet mendimet e Ministrisë së Financave dhe vlerësimin e tij për marrjen në konsideratë të tyre.

12. Projekti i programit buxhetor afatmesëm përfundimtar miratohet nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore, **jo më vonë se data 25 dhjetor.**

Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore merr masa për të publikuar dokumentin e plotë të programit buxhetor afatmesëm, përfshirë dokumentacionin shoqërues të tyre, **jo më vonë se data 31 dhjetor.**

13. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore paraqet për miratim në këshill projektbuxhetin vjetor, sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 40, të këtij ligji, **jo më vonë se data 30 nëntor e vitit buxhetor.**

Bazuar në vlerësimin e të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor, këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore, **jo më vonë se data 25 dhjetor**, miraton projektbuxhetin sipas përcaktimeve në shkronjat "a", "b", "c" e "ç", të pikës 3, të nenit 40, të këtij ligji.

14. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore merr masa për të publikuar buxhetin vjetor, përfshirë dokumentacionin shoqërues të tij, në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në faqen zyrtare të njësisë së vetëqeverisjes vendore jo më vonë se 15 ditë pas miratimit nga këshillat e njësisive përkatëse. Një kopje e buxhetit vjetor vendor dërgohet në Ministrinë e Financave jo më vonë se 5 ditë nga data e miratimit të tij.

-Ky vendim hyne ne fuqi 01.01.2018

